



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:198838  
Datë: 27.05.2024  
Numri i dokumentit: 05739365

Ac.nr.8627/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nora Bllaca Dula, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Ylber Shurdhiqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.M, nga P....., rruga “M.....”, D....., kundër të paditurës T.K sh.a, me seli në P....., të cilën sipas autorizimit i përfaqëson H.S, lidhur me çështjen kontestuese anulim i kontratës, kthim i gradës dhe kompensim i diferencës së pagave, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2564/15, i datës 06.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit Z.M, nga Prishtina, rruga “M.....”, ....., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2564/15, i datës 06.12.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2564/15, i datës 06.12.2019, ka vendosur si në vijim: “ *I. REFUZOHET E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit Z.M, nga P....., rruga “M.....”, ....., me të cilën ka kërkuar që të Anulohet dispozita e nenit 5, e kontratës së punës e lidhur me datë 02.09.2015, me të cilën paditësit i është caktuar grada 7 dhe të njëjtit t’i kthehet grada 9, të cilën e ka pasur me kontratën e punës të datës 20.10.2011, dhe të DETYROHET e paditura T.K sh.a., me seli në P....., që paditësit, t’ia paguaj diferencën e pagës në mes të gradës 7 dhe 9, për periudhën kontestuese nga data 01.09.2015, kur ka hy në fuqi*

*kontrata e punës e deri ma datë 31.05.2019, kur është përpiluar ekspertiza, në shumë prej 8,348.69 € neto, me kamat prej 8% prej datës 30.10.2015 kur është paraqitur padia e deri në pagesën definitive, në emër të kontributit personal t'ia paguaj shumën 976.46 €, në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në emër të tatimit shumën prej 927.63 €, në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 150.00 €, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. II. Secila nga palët i bartë shpenzimet e veta procedurale”.*

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi përmes të autorizuarit të tij, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet ankesa, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallë së parë dhe të aprovohet kërkesëpadija e paditësit si e bazuar ose të priset aktgjykimi dhe çështje të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala e paditur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e palës paditëse është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi me datën 03.05.2012, kundër të paditurës, duke kërkuar anulim të kontratës, kthim i gradës dhe kompensim i diferencës së pagave, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkallës së parë, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, e më detajisht sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadiës së paditësit, pas shqyrtimit gjyqësor dhe pas provave të administruara ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.2564/15 të datës 06.12.2019, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pabazuar, për faktin se paditësi në cilësi të punësuarit dhe e paditura në cilësi të punëdhënësit, raportin e tyre punëdhënës - punëmarrës e kanë rregulluar me kontratë, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke në bazë të kontratës Nr.01-4145/100/2015, datë 02.09.2015, e cila është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht me dispozitën e nenit 11 të këtij ligji, ku është paraparë se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe sipas nenit 11 par.1, nën-paragrafi 1.8, të Ligjit të Punës, kontrata e punës duhet të përmbajë lartësinë e pagës bazë si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër. Në rastin konkret palët me kontratë, përkatësisht me nenin 5 të kontratës së lartcekur kanë paraparë së të punësuarit, këtu paditësit t'i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për

punëdhënësin në lartësi të gradës 7 paditësi, e të cilën e ka nënshkruar paditësi, ku gjykata ka vlerësuar se kontrata në fjalë është lidhur mes palëve ndërgjyqëse është një marrëdhënie kontraktuese, duke u respektuar kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës, edhe atë aftësia punuese e palëve kontraktuese, vullneti i palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Gjykata ka shtuar se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës TK, përcakton se paga e punëtorit paguhet sipas gradës 7, e të cilën vetë paditësi e ka nënshkruar, se gjykata ka vlerësuar se e njëjta është në harmoni dispozita ligjore të Ligjit e Punës, andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e dispozitës së nenit 5 të kontratës së punës të lidhur me datë 02.09.2015, me të cilën paditësit i është caktuar grada 7 dhe kthimi i gradës 9, të cilën e ka pasur me kontratën e punës të datës 20.10.2011, të lidhur me punëdhënësin Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, ashtu siç ka kërkuar paditësi, për arsye se pas ndarjes së PTK-së në PK sh.a. dhe TK sh.a, paditësi ka lidhur kontratë pune në kohë të pacaktuar me TK sh.a. dhe sipas nenit 5 të kontratës është caktuar paga bazë sipas gradës 7 dhe se kjo kontratë është nënshkruar nga paditësi. ku sipas nenit 24 të kësaj kontrate i njëjti ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e kontratës. Prandaj paditësi ka dështuar të provoj faktin së këtë kontratë e ka lidhur me detyrim, mashtrim apo lajthim. Poashtu paditësi nuk e ka provuar faktin se me rastin e lidhjes – nënshkrimit të kontratës Nr.01-4145/100/2015, datë 02.09.2015, të ketë paraqitur kundërshtim në lidhje gradën e cila i është caktuar me këtë kontratë dhe sipas vlerësimit të gjykatës, në qoftë se paditësi ka qenë i pakënaqur me përmbajtjen e kontratës, përkatësisht me gradën 7 i njëjti ka pasur mundësi që ta bëjë një kundërshtim të tillë. Në rastin konkret ankesa me të cilën ka kërkuar sqarime paditësi është paraqitur të Komisioni i Ankesave në PTK, me datë 01.10.2015, ndërsa kontrata e punës për kohë të pacaktuar Nr....., mban datën 02.09.2015, që do të thotë që ankesa është paraqitur pas nënshkrimit të kontratës. Gjykata ka vlerësuar se kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës mund të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të dy palëve kontraktuese dhe se ndryshimi i kushteve të kontratës, në këtë rast ndryshimi i gradës nga 7 në 9 siç ka kërkuar paditësi, nuk mund të bëhet me vendim të gjykatës, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me vullnetin e të paditurës, e që në këtë rast do të cenohej njëri nga kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës, siç është vullneti i palëve kontraktuese dhe për këto arsye gjykata e refuzoi të pathemeltë edhe kërkesën e paditësit për pagesën e diferencës së pagës në mes të gradës 7 dhe 9, për periudhën kontestuese nga data 01.09.2015, kur ka hyrë në fuqi kontrata e punës e deri me datë 31.05.2019, kur është përpiluar ekspertiza, në shumën prej 8,348.69 € neto, kontributit personal shumën 976.46 €, tatimit në pagë në shumën prej 927.63 €.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë ka aplikuar dispozitat materiale të nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.8 të Ligjit të Punës, nenin 7.1 dhe 319.1 të LPK-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi konform dispozitës së nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është në kundërthënie të plotë me arsyetimin e dhënë dhe me provat që gjenden në shkresat e lëndës, ku nga referati i ankesës rezulton që thirret në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyetimin e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për vlerësimin e themelësisë së kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, si dhe përfundimin e gjykatës për pathemelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, duke u mbështetur në provat e administruara të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë nga gjykata e shkallës së parë dhe rrjedhimisht, duke zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit nuk i pranon pretendimet ankimore të palës ankuese për vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, për arsye se kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, duke vërtetuar se paditësi pas ndarjes së PTK-së, në PK, sh.a. dhe TK, sh.a, paditësi me TK, sh.a. ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke në bazë të kontratës Nr....., datë 02.09.2015, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për anulimin e dispozitës së nenit 5 të kontratës së punës të lidhur me datë 02.09.2015, me të cilën paditësit i është caktuar grada 7 dhe kthimi i gradës 9, të cilën e ka pasur me kontratën e punës të datës 20.10.2011, të lidhur me punëdhënësin PTK, për arsye se sipas nenit 5 të kontratës është caktuar paga bazë sipas gradës 7, se kjo kontratë është nënshkruar nga paditësi dhe se kontrata në fjalë është marrëdhënie kontraktuese, e lidhur duke u respektuar kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës, edhe atë aftësia punuese e palëve kontraktuese, vullneti i palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës, e cila është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit e ka pranuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, se kontrata e punës e lidhur në mes paditësit dhe të paditurës mund të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të dy palëve kontraktuese dhe se ndryshimi i kushteve të kontratës, në këtë rast ndryshimi i gradës nga 7 në 9, siç ka kërkuar paditësi, nuk mund të bëhet me vendim të gjykatës, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me vullnetin e të paditurës, e që në këtë rast do të cenohej njëri nga kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës, siç është vullneti i palëve kontraktuese dhe për këto arsye gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar të pathemeltë edhe kërkesën e paditësit për pagesën e diferencës së pagës në mes të gradës 7 dhe 9, për periudhën kontestuese nga data 01.09.2015, kur ka hyrë në fuqi kontrata e punës e deri ma datë 31.05.2019, kur është përpiluar ekspertiza, në shumën prej 8,348.69 € neto, kontributit personal shumën 976.46 €, tatimit në pagë në shumën prej 927.63 €.

Gjykata e Apelit vlerëson se paditësi me faktin e lidhjes së kontratës ka hyrë në raport juridiko-detyrimor me të paditurën, me datë 02.09.2015, ka nënshkruar kontratë me të paditurën, ku ka pranuar gradën 7, ku paditësi me rastin e nënshkrimit të kontratës, i ka pasur të njohura të gjitha faktet dhe rrethanat e parapara me kontratë dhe me nënshkrimin e kontratës i ka pranuar kushtet dhe detyrat e punës për lartësinë e gradës 7 dhe pozitën në fjalë. Paditësi me vullnetin e tij ka hyrë në marrëdhënie pune, respektivisht ka pranuar kushtet e punës të të paditurës, respektivisht i ka pasur të njohura të gjitha rrethanat para se ta nënshkruaj kontratën, ku sipas nenit 7 të LPK-së, parashihet se: *“palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me nenin 319.1, i të njëjtit ligj parashihet se *“secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, andaj meqenëse se kërkesa e paditësit për anulimin e dispozitës së nenit 5 të kontratës së punës të datës 02.09.2015, me të cilën paditësit i është caktuar grada 7 dhe kthimi i gradës 9, të cilën e ka pasur me kontratën e punës të datës 20.10.2011, është e pathemeltë, poashtu edhe kërkesa për pagesën e diferencës së pagës në mes të gradës 7 dhe 9, për periudhën kontestuese nga data 01.09.2015, është e pathemeltë, andaj gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Sipas nenit 3 paragrafi 1.10 të Ligjit të Punës, përkufizon marrëdhënien e punës e cila është: *“një marrëveshje ose rregullim kontraktual ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi specifike nga i punësuarit nën mbikëqyrjen e punëdhënësit kundrejt një pagese të dakorduar, zakonisht në formë të parave”*, me nenin 17.1 të këtij ligji parashihet se *“I punësuarit caktohet në vendin e punës për të cilin ka lidhur Kontratë Pune”*, ndërsa me nenin 1.1 të këtij ligji parashihen kushtet dhe përmbajtja e kontratës së punës, si dhe me nenin 11 të këtij ligji, është paraparë se çka duhet të përmbajë kontrata e punës dhe sipas nenit 11 par.1, nën-paragrafi 1.8, të Ligjit të Punës, kontrata e punës duhet të përmbajë *“lartësinë e pagës bazë si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër”*, nga çka rezulton se paditësi me vullnetin e tij ka hyrë në marrëdhënie pune, i ka pranuar kushtet e punës, ka nënshkruar kontratën e punës, ku palët janë pajtuar për elementet thelbësore të kontratës konform nenit 16 të LMD-së, andaj pretendimet e paditësit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale janë të pathemelta.

Sa i përket pretendimeve për diskriminim, pala paditëse nuk ka arritur të bindë gjykatën se nga cila bazë ka qenë i diskriminuar paditësi, sepse lidhja e kontratës së punës, përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve kontraktuese, nënshkrimi i kontratës nuk mund të interpretohet si diskriminim, pasi që e njëjta është lidhur në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, ndërsa neni 5 i Ligjit të Punës përcakton në mënyrë të qartë rastet se kur ekziston diskriminimi, e që në rastin konkret lidhja e kontratës në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, nuk mund të quhet diskriminim.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë, e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë rrethanat e këtij rasti, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, për arsyet e lartcekura, nga çka rezulton se është zbatuar drejtë e drejta materiale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita nga neni 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.8627/2021, datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Nora Bllaca Dula, d.v